

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani, Isa Kelmendi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit V. G. nga P., kundër vendimit e të paditurës – Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor (MMPH), në çështjen administrative-anulim i vendimit nr..... dt....., duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit KMLA nr.4/2014 dt.25.07.2014, për mbrojtjen e ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.180/2014 dt.28.04.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me 31.01.2018, mori këtë

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e Prokurorit të Shtetit KMLA nr.4/2014 dt.25.07.2014, për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.180/2014 të datës 28.04.2014.

### **A r s y e t i m**

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.180/2014 të datës 28.04.2014, është refuzuar ankesa e propozuesit-paditësit V. G., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative A.U.nr.358/14 dt.19.03.2014, me të cilin është refuzuar si i pabazuar propozimi i paditësit V. G., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurit-MMPH nr.... dt....., deri në vendosje sipas padisë së paditësit.

Kundër aktvendimeve të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.180/2014 dt.28.04.2014, dhe të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dep.administrativ, A.U.nr.358/14 dt.19.03.2014, Prokurori i Shtetit ka parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë me nr. KMLA nr.4/2014 dt.25.07.2014, për shkak të shkeljes të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, me propozim që ta aprovohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, të dy aktvendime të kontestuar të ndryshohen duke e aprovuar kërkesën e propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, deri në përfundimin e plotëfuqishëm të kësaj çështje juridike.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet në kërkesë dhe pas vlerësimit të aktvendimeve të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.180/2014 dt.28.04.2014 është refuzuar si e pabazuar ankesa e propozuesit-paditësit V. G., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dep.administrativ A.U.nr.358/14 dt.19.03.2014, me të cilin është refuzuar si i pabazuar propozimi i paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurit-MMPH nr..... dt....., deri në vendosjen sipas padisë së paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimeve të gjykatave të instancës më të ulët, vlerëson si të drejta aktvendimet e kontestuara, duke i zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative (03/L-202).

Neni 22.2 i Ligjit për Konfliktet Administrative parasheh se shtyrja mund të bëhet me kërkesën e paditësit, organi,akti i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyje ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispoziten e nenit 22.6 të të njëjtit ligj përcaktohet se paditësi mund të kërkoj nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor , sipas kushteve të paraparë në nenin 22 par.2 të LKA-së .

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e shqyrtuar kërkesën e paditësit gjen se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë A.U.nr.358/14 dt.19.03.2014, me të cilin është refuzuar si i pabazuar propozimi i paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurit MMPH nr..... dt....., deri në marrjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë sipas padisë së paditësit.

Pra, në këtë rast, Prokurori i Shtetit me kërkesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshëm me asnjë provë të vetme faktin se shtyrja e ekzekutimit, nuk është në kundërshtim me interesin publik. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 22 të LKA-së. Për këto arsye, kjo Gjykatë vendosi ta refuzoj kërkesën e Prokurorit të Shtetit, për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA nr.180/2014 dt.28.04.2014.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për konfliktin administrativ. Janë të pabazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, dhe janë të pa ndikim për vendosjen në mënyrë tjetër, ngase vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të goditur përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejtë të drejtës materiale.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1, lidhur me nenin 22.2 dhe 6 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

ARJ-UZVP nr.1/2018 dt. 31.01.2018.

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi